



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1871, datë 11.04.2012

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelcom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 11.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelcom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Abissnet sh.a. me nr. 701Prot, datë 31.1.2012, drejtuar Albtelecom sh.a. “*Në lidhje me draft marrëveshjen e interkoneksionit për ofrimin e shërbimeve të thirrjes me kartë*”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 588/1Prot., datë 17.2.2012, drejtuar Abissnet sh.a. “*Përgjigje tuajës datë 3.2.2012*”;
- Procesverbali i mbajtur me datë 26.3.2012, mes palëve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.;
- Shkresa e Abissnet sh.a. me nr. 1875Prot. datë 2.4.2012, *Qëndrimi i Abissnetj lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit për ofrimin shërbimeve të thirrjes me kartë me Albtelecom*”;
- Korrespondenca e shkëmbyer me e-mail mes këtyre dy sipërmarrësve,
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe, duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Abissnet sh.a., me shkresën nr. 417Prot. i AKEP, datë 2.3.2012, “*Zgjidhja e mosmarrëveshjes me Albtelecom sh.a., lidhur me draft marrëveshjen për ofrimin e shërbimeve të thirrjes me kartë*”, sqaron si me poshtë:

1. Abissnet sh.a. është njoftuar nga Albtelecom sh.a. shkresa nr. 4958Prot., datë 2.11.2011, për draft marrëveshjen e re të interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë;

Në aneksin nr. 4, të draft MI të shërbimeve të thirrjes me kartë, pika I.2, “Tarifa për shërbimet e aksesit në pikën e akses interkoneksionit” fq. 37 është parashikuar detyrimi për Abissnet, për të paguar një tarifë (qira) mujore prej 20 000 lekë/muaj për çdo sistem E1;

Ky detyrim është i papranueshëm nga Abissnet, duke qenë se Abissnet ka investuar duke përballuar koston e instalimit dhe duke kryer të gjitha punimet e nevojshme për realizimin e instalimit të qarkut E1. Për realizimin e shërbimit të interkoneksionit të shërbimeve me kartë shfrytëzohet infrastruktura e Abissnet;

2. Në draft marrëveshjen interkoneksionit, neni 14, pika 5, parashikohet: *“Nëse operatori i thirrjes me kartë nuk kryen pagesat brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, atëhere do të aplikohet kamatvonesë në masën 0.5 % të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike që tejkalohet ky afat, po jo më shume se 10 ditë në vijim”.*

Kamatvonesa prej 0.5 %, është 15 herë më e lartë se interesat bankare që zbatojnë bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, pra është e papranueshme për Abissnet. Gjithashtu, bie në kundërshtim edhe me vendimin unifikues nr. 932. Datë 22.6.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

3. Abissnet, i ka komunikuar në formë elektronike Albtelecom-it, se nuk i pranon si tarifën prej 20 000 lekë/muaj, ashtu edhe kamatvonesën prej 0.5% për çdo ditë vonesë. Albtelecom gjithashtu, në formë elektronike është përgjigjur duke mos i pranuar pretendimet e Abissnet.
4. Abissnet, me shkresën nr. 701Prot., datë 31.1.2012, duke i parashtruar pretendimet si më lart, i kërkon Albtelecom ndryshimet në draft MI e interkoneksionit për shërbimet me kartë:
 - Ndryshim në pikën 5, neni 14, *“Nëse operatori i shërbimeve të thirrjes me kartë nuk kryen pagesat brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, atëhere do të aplikohet kamatvonesë në masën 0.05 % të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike që tejkalohet ky afat, po jo më shume se 30 ditë në vijim”.*
 - Heqjen e detyrimit të shoqërisë Abissnet për të paguar një tarifë mujore prej 20 000 lekë/muaj për çdo sistem 2 Mbit/s (ose E1).
5. Albtelecom me shkresën nr. 588/1, datë 17.2.2012, “Përgjigje shkresës tuaj” sqaron Abissnet se:
 - Janë ezauruar të gjithë afatet për diskutim e negociim të pretendimeve të ngritura sepse kanë kaluar më shumë se 2 muaj nga njoftimi i Albtelecom me nr. 4958Prot., datë 2.11.2011, për nënshkrimin e MI;
 - Pretendimi i Abissnet në lidhje me kamatvonesën është ezauruar me VKD nr. 1699, datë 20.10.2011, për mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit mes Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a., duke lënë në fuqi aplikimin e kamatvonesës;

- Për heqjen e detyrimit për pagesën e tarifës prej 20 000 lekë/muaj për çdo sistem 2 Mbit/s (E1), pretendimi i Abissnet nuk qëndron sepse kjo pagesë nuk ka të bëjë me shfrytëzimin e sistemit E1 nga ana e Abissnet, por është tarifë për portën e aksesit që Albtelecom vendos në dispozicion të Abissnet për ofrimin e shërbimeve të akses/interkoneksionit për thirrjen me kartë. Kjo tarifë është aplikuar dhe ka ekzistuar edhe në marrëveshjen aktuale mes palëve dhe është paguar rregullisht nga ana Abissnet.
 - Gjithashtu, Albtelecom i kujton Abissnet pagesën e detyrimeve të prapambetura dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për lidhjen e Marrëveshjes së re Interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë.
6. Meqënëse Albtelecom sh.a., nuk i ka pranuar kërkesat e Abissnet sh.a., Abissnet sh.a. kërkon nga AKEP shqyrtimin e mosmarrëveshjes për pikat e më lartpërmendura dhe ndërhyrjen e tij për të bërë ndryshime në ORI dhe draft MI për shërbimet e thirrjes me kartë, në mënyrë që të mos aplikohet zbatimi i tyre nga Albtelecom sh.a.
 7. AKEP, me datë më datë 26.3.2012, ora 11:00, në seancën paraprahe në lidhje me shqyrtimin e shkresës së Abissnet me nr. 417Prot. i AKEP, datë 2.3.2012, zhvilloi një takim mes palëve. Edhe pse palët në këtë takim mbajtën të njëjtin qëndrim si më parë në pretendimet e tyre, nga AKEP, u rekomandua të rishikohen edhe njëherë qëndrimet e tyre, dhe të informonin brenda një jave për zhvillimet e mëtejshme. Për pretendimin e Abissnet në lidhje me kamatvonesën nga AKEP u theksua se është ezauruar me VKD nr. 1699, datë 20.10.2011, (për këtë pikë Abissnet ra dakord).
 8. Abissnet, me shkresën 1875Prot., datë 2.4.2012, njofton “*Qëndrimin e saj lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit për ofrimin shërbimeve të thirrjes me kartë me Albtelecom*” dhe kërkon ndërhyrjen e AKEP për të shqyrtuar mosmarrëveshjen e interkoneksionit dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme në ORI-in e Albtelecom dhe draft marrëveshjen e interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë, në mënyrë që të mos aplikohet zbatimi i tyre nga Albtelecom.
 9. Duke qënë se, sipërmarrësit Abissnet sh.a., dhe Albtelecom sh.a. megjithë negociatat, dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë midis tyre, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimet e thirrjes me kartë midis Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Ded Jakaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE